



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 396/4 Prot.

Tiranë, më 10/06/ 2019

V E N D I M

Nr. 66 , Datë 10 / 06 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.21 Regj., datë 13.03.2019, të K. M, kundër Bashkisë së Tiranës, me pretendim diskriminimin për shkak të “*bindjeve politike*¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, K. M me Urdhërin nr.25157, datë 27.06.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë është emëruar Nën/Kryetare e Bashkisë së Tiranës. Ndërsa, rezulton se është shkarkuar nga detyra dhe i është zgjidhur kontrata e punës më këtë Institucion, nëpërmjet Urdhërit me nr.8150, datë 18.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë.

Ankuesja ngre pretendimin se shkarkimi nga detyra e Nën/Kryetares së Bashkisë ka ardhur si pasojë e pjesëmarrjes së saj në protestën e datës 16.02.2019, si anëtare e subjektit politik, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU). Ajo citon se me datë 18.02.2019 është njoftuar përmes miqve dhe mediave se ishte shkarkuar nga detyra e Nën/Kryetares së Bashkisë nga Kryetari i saj, z.Erion Veliaj, për shkak të pjesëmarrjes në protestë.

Ankuesja thekson faktin se data 16 Shkurt, kur ajo mori pjesë në protestë ishte ditë e shtunë dhe si e tillë ishte ditë pushimi. Ndërsa me datë 18.02.2019 ka qenë në punë dhe nuk i është komunikuar zyrtarisht asnjë shkresë nga strukturat përkatëse të Institucionit, lidhur me largimin nga puna. Me datë 19.02.2019 subjekti ankues shprehet se është kontaktuar në telefon nga Drejtoresha e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, znj.K.L, e cila më pas gjatë takimit me të i ka konfirmuar

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e saj në forcën politike të subjektit politik, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) me kartën e anëtarësisë me nr.000030 dhe Vërtetimin nr.130 prot., datë 13.03.2019, të Kryetarit të PDIU.

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

largimin e saj nga detyra si dhe shkakun që kishte çuar në një vendimmarrje të tillë nga Kryetari i Bashkisë, që ishte pikërisht pjesëmarrja në protestën e 16 Shkurtit 2019.

Shkarkimi i K. M nga detyra e Nën/Kryetares së Bashksë Tiranë është bërë objekt i disa shkrimeve në portale të ndryshme të datës 18 Shkurt 2019, ndër të cilat ankuesja citon Portalin Boldnews.al, i cili ka publikuar një artikull me titull: *“Ekskluzive/Lali Eri mbështet protestën e opozitës, zyrtarët e tij në protestë”*, shoqëruar dhe me foto të pjesëmarrësve, ndër të cilët edhe ajo.

Në këtë artikull shkruhej: *“Teksa sheshi para Kryeministrisë mbajti mijëra protestues të opozitës, Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj priste me padurim momentin e madh të flakës që mund të digjte politikisht Kryeministrin Edi Rama. Ai u angazhua jo vetëm shpirtërisht, por edhe me forcat e tij, duke dërguar zyrtarët e Bashkisë në ballë të protestës dhe tentuar të yshtin njërëzit për kataklizmonë e madhe.*

Në protestën masive të thirrur nga opozita me 16 Shkurt, në ballë të një grupi të përfaqësuesve të PDIU-së ishte Kryetari Shpëtim Idrizi, ndërsa më pas krahët e ngrohtë ia mbante Nën/Kryetarja e Bashkisë Tiranë, K. M dhe Drejtori i Tregjeve në Kryeqytet S. H.

Edhe pjesa tjetër që hiqte “kortezhin çam”, përbëhej nga nëpunës të lartë të Bashkisë Tiranë, që kishin marrë “leje” nga Veliaj për të qenë aty në ditën e madhe, me shpresën se Rama nuk do të kthehej më nga Vlora dhe Erion Veliaj të kishte një “shteg” të hapur drejt Kryeministrisë.

Veliaj është aty, si blerësi kryesor i çdo produkti që në fund vlen për qëllimin kryesor, rënien e Ramës. Ndaj punonjësit e lartë të tij dhe armata tjetër që figuron në borderotë e Bashkisë Tiranë, ditën e protestës së opozitës ishin të shumtë kundër Ramës”.

Fakti i shkarkimit të K. M ishte bërë publik dhe në media të tjera si, Gazeta Panorama, portali Dosja.al, portali 27.al, etj, të cilët përmes artikujve të tyre artikulonin se punonjësit e Bashkisë Tiranë u shkarkuan nga z.Veliaj për shkak se ishin anëtarë të PDIU-së: *“Lali Eri merr hak për llogari të Ramës. Shkarkon zyrtarët e PDIU, pse morën pjesë në protestë, etj”.*

Subjekti ankues citon se: *“Bashkia e Tiranës mban qëndrim tjetër ndaj punonjësve të saj që janë anëtarë të Partisë Socialiste, kur ata marrin pjesë në aktivitete politike dhe nuk i largon nga puna. Ky është një fakt i bërë publik përmes postimeve të fotove që këta punonjës kanë bërë në rrjetet sociale, në aktivitetin e organizuar nga Partia Socialiste në Sheshin “Nënë Tereza” në Tiranë, me datë 23 Mars 2019”.*

Ankuesja ka bashkëngjitur foto ilustruese të z.A. S me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë Tiranë, z.T. T me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Punëve Publike, znj.T. J me detyrë Administratore e Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, z.F. P me detyrë Administrator i Njesisë Bashkiake nr.2, Tiranë, z.A. B me detyrë Drejtor Drejtorie dhe znj.V. S me detyrë këshilltare pranë Bashkisë Tiranë.

K. M ka pretenduar se, Kryetari i Bashkisë së Tiranës e ka diskriminuar atë përmes largimit nga puna për shkak të bindjeve të saj politike dhe të pjesëmarrjes në një protestë të ligjshme.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të saj, nga ana e punëdhënësit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.421 prot., datë 19.03.2019 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Bashkisë së Tiranës lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Me shkresën me nr.12621/1 prot., datë 17.04.2019 Bashkia Tiranë ka informuar Komisionerin se:

“Në mbështetje të nenit 64, shkronja “e” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë emëron duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarët e Bashkisë dhe i shkarkon ata. Gjithashtu, sipas Kreut XIV “Përfundimi i marrëdhënies së punës”,

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

neni 153, pika 1, e Kodit të Punës, për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit vijimin e marrëdhënieve të punës, përcaktohet përfundimi i mënjëhershëm i kontratës së punës nga punëdhënësi apo punëmarrësi në çdo kohë për shkaqe të justifikuara”.

Në rrjedhim të sa mësipër, Bashkia Tiranë thekson se shkarkimi i K. M me detyrë Nën/Kryetare e Bashkisë Tiranë është kryer në përmbushje të rregullave ligjore dhe parimit të mirëbesimit siç parashikohet në nenin 153, pikën 2, të Kodit të Punës, ku vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të padrejtë të pretenduar nga subjekti ankues.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se subjekti ankues, K. M me Urdhërin nr.25157, datë 27.06.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë është emëruar Nën/Kryetare e Bashkisë së Tiranës. Ndërsa, rezulton se është shkarkuar nga detyra dhe i është zgjidhur kontrata e punës më këtë Institucion, nëpërmjet Urdhërit me nr.8150, datë 18.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë.

Subjekti ankues ka ngritur pretendimin se shkarkimi nga detyra e Nën/Kryetares së Bashkisë ka ardhur si pasojë e pjesëmarrjes së saj në protestën e datës 16.02.2019, si anëtare e subjektit politik, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU).

Në analizë të fakteve dhe shkaqeve të pretenduara nga K. M, si dhe referuar dokumentacionit dhe kronologjisë së ngjarjeve, Komisioneri konstaton se:

Pretendimi i ankueses se është larguar për shkak të bindjeve politike dhe pjesëmarrjes së saj në protestën e opozitës, të datës 16 Shkurt 2019; është haptazi i pabazuar, për arsytet poshtëcitur:

- *Së pari*, Kryetari i Bashkisë së Tiranës i ka ditur dhe njohur bindjet politike të ankueses, qënien e saj në PDIU, që në momentin e emërimit të saj në këtë detyrë.
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 59 dhe 64 të tij ka përcaktuar si kompetencë të drejtëpërdrejtë të Kryetarit emërimin, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, të zëvendëskryetarit/zëvendëskryetarëve të Bashkisë dhe shkarkimin e tyre.
- Neni 59, pika 3 e tij citojnë se: *“Kryetari i Bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga Kryetari i Bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga Kryetari i Bashkisë”*.
- Këto kompetenca theksohen rishtaz dhe në nenin 64, pika e e tij, ku citohet se Kryetari i Bashkisë: *“Emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e Bashkisë dhe i shkarkon ata”*.
- Sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së në zgjedhjet vendore të vitit 2015 Partia Socialiste (PS) (anëtar i së cilës është edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë) dhe PDIU-ja kanë garuar së

bashku në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”. Në këto kushte, largimi i ankueses nga detyra nuk ka të bëjë me qënien e saj si anëtare partie në subjektin politik PDIU, në të vërtetë rezulton e kundërta: që ankuesja, K. M është emëruar Zv/Kryetare e Bashkisë së Tiranës, krahas plotësimit të kriterëve të tjera, edhe për shkak të përkatësisë së saj në subjektin politik PDIU. Kjo për shkak të qënies së këtij subjekti në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, nën siglën e së cilës, Kryetari i Bashkisë ka fituar zgjedhjet vendore në Bashkinë Tiranë.

- Që ankuesja nuk është larguar nga detyra për shkak të përkatësisë së saj partiake, provohet edhe me faktin se, edhe kur strukturat e subjektit PDIU (Këshilli Kombëtar i kësaj force politike) kanë zyrtarizuar daljen nga koalicioni qeverisës (me datë 10.09.2018), ku bën pjesë partia kryesore PS-ja, anëtar i së cilës është edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, ky akt, pra dalja e subjektit PDIU në opozitë zyrtare, nuk ka shërbyer si shkak që ankuesja të largohet nga puna. Përkundrazi, edhe pas këtij vendimi të forumit më të lartë të PDIU-së, Këshillit Kombëtar të tij, ankuesja ka vazhduar të ushtrijë detyrën dhe funksionin e saj si Zv/Kryetare e Bashkisë Tiranë për rreth 5 muaj.
- *Së dyti*⁴, Komisioneri vlerëson se, *prima facie*, duket se largimi i ankueses nga detyra është bërë për shkak të pjesëmarrjes së saj në protestën e 16 Shkurtit, të organizuar nga forcat opozitare.

Për të pasur një gjykim sa më objektiv dhe tablo sa më të qartë, duhet të evidentohen dhe mesazhet para dhe gjatë protestës të 16 Shkurtit 2019, në raport me pozicionin zyrtar të ankueses si Zv/Kryetare e Bashkisë Tiranë. Ndër të tjera forcat opozitare kanë artikuluar duke kundërshtuar fort projektet infrastrukturore të ndërtimit të një segmenti të Unazës së Re (e quajtur Zona e Astirit) dhe projektin për ngritjen e një godine të re të Teatrit Kombëtar, që sipas Opozitës janë projekte në shkelje të normave ligjore të transparencës, konkurrencës, dhe për më tepër janë afera korruptive dhe në dëm të interesit publik.

Në lidhje me këto dy projekte, qëndrimi zyrtar i Bashkisë së Tiranës, bazuar dhe në deklaratimet e herë pas herëshme të Kryetarit të saj, ka qenë në favor të tyre dhe që do i shërbenin interesit të gjerë publik, në aspekt të lehtësimit të lëvizjes përmes përmirësimit cilësor të infrastrukturës rrugore të Unazës së Re, e po ashtu, ndërtimi i një teatri bashkëkohor me ambientet e duhura dhe funksionale, në dobi dhe interes të aktorëve dhe publikut.

Pikërisht, marrja pjesë e ankueses në protestën e 16 Shkurtit 2019, në mbështetje të kauzave të mësipërme: pra, kundërshtimi dhe mosqenia dakort me procedurat ligjore të projektit të Unazës së Re (segmenti i Astirit) si dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, bie ndesh me pozicionin zyrtar të ankueses si Zv/Kryetare e Bashkisë Tiranë. Këto dy projekte jo vetëm që po zhvillohen në territorin që administron kjo Bashki, por kjo e fundit është deklaruar publikisht dhe zyrtarisht në favor të zhvillimit të këtyre dy projekteve.

⁴ Lidhur me pretendimin e ankueses se është larguar nga detyra për shkak të pjesëmarrjes së saj në protestën e opozitës, të datës 16 Shkurt 2019.

Përveç sa më sipër, duhet theksuar se sipas parashikimeve të ligjit 37/2018 “Për përcaktimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, Bashkia e Tiranës ka një rol kyç dhe thelbësor në realizimin dhe implementimin e këtij ligji.

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Tiranë, sipas këtij ligji janë në tërësinë e tij dhe veçanërisht në nenin 3, pikat 1,2,3,8,12; nenin 6, pika 6; nenin 7, pikat 4,5,8,9,13,14; nenin 8, germa ç) e tij.

Mjafton të citohet neni 5.1 i këtij ligji, sipas të cilit komisioni negociues kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Bashkia e Tiranës, dhe neni 9.1 i tij, sipas të cilit nënshkrimi i kontratës bëhet nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për të kuptuar se Bashkia Tiranë është subjekti juridik për zbatimin e këtij ligji.

Në këto kushte, marrja pjesë e ankueses në protestën e 16 Shkurtit 2019, ku disa ndër artikulumet e opozitës së bashkuar, para dhe gjatë kësaj proteste kanë qenë dhe procedurat për projektin e Unazës së Re dhe godinës së Teatrit Kombëtar, bie ndesh dhe është i papajtueshëm me pozicionin zyrtar të ankueses si Zv/Kryetare e kësaj Bashkie.

Komisioneri, thekson se, në një shoqëri të lirë dhe demokratike, e drejta e protestës është thelbësore dhe e garantuar nga Kushtetuta.

Por në rastin konkret, nuk ndodhemi para një situatë të disfavorshme për shkak të pjesëmarrjes në protestë por të manifestimit të qendrimeve dhe pikëpamjeve thelbësisht të kundërta me Bashkinë Tiranë (Punëdhënësin) dhe lidhet ngushtësisht me funksionin e ankueses.

Në këtë kontekst, referuar parashikimeve të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (nenet 59, 64) dhe Rregullores së Bashkisë “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Tiranës”, të ndryshuar, zv/kryetari i Bashkisë emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari, edhe se zv/kryetarët bëjnë pjesë në kabinetin e Kryetarit, si dhe Kryetari i Bashkisë ndihmohet nga zv/kryetarët në kryerjen e funksioneve, dhe se këtyre të fundit ju caktohen detyrat dhe fushat e veprimtarisë nga Kryetari. Madje, dhe detyra të posaçme përmes delegimit, pra zv/kryetarët përmes punës dhe veprimtarisë së tyre përfaqësojnë Kryetarin e Bashkisë. Kryerja e veprimeve që jo vetëm nuk rrjedhin nga funksioni i zv/kryetarit, që nuk janë caktuar, deleguar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të këtij të fundit, madje janë diametralisht të kundërta me Kryetarin e Bashkisë, qofshin këto qëndrime të shprehura edhe përmes protestës; përbëjnë cënim të rëndë të raportit të ngushtë që duhet të ekzistojë midis Kryetarit të Bashkisë dhe Zëvendës Kryetares së tij. Për rrjedhojë, mbajtja e qendrimeve thelbësisht të kundërta në çështje të konsideruara esenciale nga Kryetari i Bashkisë nga një funksionare e lartë (e dyta për nga rëndësia) e lidhur ngushtë në një raport besimi me Kryetarin të cilin shpesh sipas Ligjit 139/2015 dhe Rregullores së Bashkisë Titanë⁵ mund edhe ta zëvendësojë në situata të ndryshme publike dhe ligjore, përbën një cënim të parimit të mirëbesimit ndaj punëdhënësit, dhe për rastin konkret shërben si një shkak i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Në këto kushte, largimi i ankueses nga detyra nuk mund të konsiderohet se është bërë për shkaqe diskriminuese.

⁵ Shiko nenin 31 të Rregullores.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekzpozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e Bashkisë së Tiranës.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike dhe të pjesëmarrjes në protestën e datës 16.02.2019, të pretenduar nga ankuesja.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të ankueses se Bashkia e Tiranës mban qëndrim tjetër ndaj punonjësve të saj që janë anëtarë të Partisë Socialiste, kur ata marrin pjesë në aktivitete politike dhe nuk i largon nga puna, Komisioneri, bazuar në analizën e mësipërme vlerëson se K. M nuk është në kushte të njëjta me këta punonjës për të bërë të mundur krahasimin e saj me ta, apo përdorimin e analogjisë në rastin konkret, përveç z.A. S me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë Tiranë, i cili nuk rezulton të ketë demonstruar një qëndrim të kundërt me politikën e Bashkisë së Tiranës apo të kenë cënuar parimin e mirëbesimit ndaj punëdhënësit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike” të K. M, nga ana e Bashkisë së Tiranës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha : Punësim
Shkaku: Bindjet politike